Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Fotoeditim II**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**1**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**6**
Përshkrimi i lëndës	Lënda Fotoeditim II avancon njohuritë dhe aftësitë e fituara në Fotoeditim I, duke u fokusuar në teknikat profesionale të përpunimit dhe manipulimit digjital të fotografisë. Trajtohen retushimi dhe restaurimi i avancuar, menaxhimi i ngjyrave dhe toneve, puna jo-destruktive, maskat dhe kanalet e avancuara, Camera Raw, color grading, photo compositing dhe optimizimi i imazhit për media të ndryshme. Përmes projekteve praktike, studentët zhvillojnë aftësinë për të realizuar zgjidhje vizuale sipas kërkesave konceptuale dhe profesionale.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është të avancojë njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përpunimin profesional të fotografisë digjitale, duke zhvilluar kompetenca në retushim, manipulim, korrigjim të ngjyrave, compositing dhe optimizim të imazhit, si dhe aftësinë për të realizuar projekte vizuale sipas brief-it dhe standardeve profesionale.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: • Përdorë teknika të avancuara dhe workflow jo-destruktiv në Adobe Photoshop; • Analizojë nevojat vizuale dhe teknike të fotografisë para procesit të editimit; • Aplikojë teknika profesionale të retushimit, restaurimit dhe korrigjimit të imazhit; • Përdorë maska dhe kanale të avancuara, Camera Raw dhe teknika të color grading; • Realizojë manipulime kreative dhe photo compositing sipas kërkesave konceptuale; • Integrojë elemente nga Illustrator dhe InDesign në workflow-in e projektit; • Realizojë dhe prezantojë një projekt profesional sipas brief-it dhe standardeve të përcaktuara.

Kontributi në ngarkesën e studentit
(gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	1	15	15
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	3	6
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			

Detyra të shtëpisë	3	12	36

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	12	36
Përgaditja përfundimtare për provim	3	3	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	2	6
Projektet, prezentimet, etj	3	4	12
Totali			150

Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërata interaktive dhe demonstrime praktike, punë individuale në laborator, ushtrime dhe detyra javore, analizë e shembujve vizualë, diskutime dhe konsultime. Studentët zhvillojnë projekte praktike përmes të cilave zbatojnë teknikat e trajtuara dhe prezantojnë rezultatet e punës së tyre.
Metodat e vlerësimit:	60% – Punime dhe projekte praktike gjatë semestrit 10% – Prezantim dhe angazhim gjatë semestrit 30% – Projekt/provim final Totali: 100%
Literatura	
Literatura bazë:	Advanced Photoshop CC for Professionals Digital Classroom, Jennifer Smith & AGI Creative Team. The Photoshop Handbook: The Complete Photoshop Box Set for Beginners and Advanced Users, Dwayne Brown.

Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**
Java e parë:	Rishikim i workflow-it profesional në Photoshop dhe organizimi jo-destruktiv i punës.
Java e dytë:	Menaxhimi i avancuar i ngjyrave dhe Color Sampling.
***Java e tretë*:**	Strategjitë profesionale të retushimit – Clone Stamp, Healing Brush dhe Frequency Separation.
Java e katërt:	Korrigjimi i perspektivës dhe deformimeve të imazhit.
Java e pestë:	Organizimi profesional i layer-ave, Smart Objects dhe menaxhimi i projekteve komplekse.
***Java e gjashtë*:**	Automatizimi dhe optimizimi i procesit të punës – Actions dhe teknika të workflow-it.
Java e shtatë:	Maska dhe kanale të avancuara – Alpha Channels dhe përzgjedhje të avancuara.
Java e tetë:	Analizë e ndërmjetme dhe projekt praktik.
Java e nëntë:	Integrimi i tipografisë në kompozime fotografike komplekse.
Java e dhjetë:	Interoperabiliteti me Adobe Illustrator dhe Adobe InDesign.
***Java e njëmbedhjetë*:**	Color Grading profesional dhe manipulimi kreativ i imazhit.
***Java e dymbëdhjetë*:**	Redaktimi profesional sipas brief-it të klientit.
***Java e trembëdhjetë*:**	Puna me fotografi RAW dhe Adobe Camera Raw.
***Java e katërmbëdhjetë*:**	Krijimi i efekteve speciale dhe Photo Compositing.
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	Projekti final – realizimi dhe prezantimi i një kompozimi profesional.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive janë të obligueshme. Studentët duhet t'i dorëzojnë detyrat dhe projektet brenda afateve, të respektojnë integritetin akademik dhe të përdorin me përgjegjësi materialet vizuale dhe burimet e jashtme.